

Master Profesional në Shkenca të Aplikuara, *profili* “Menaxhim i Teknologjisë së Informacionit”

Master Profesional në programin “Menaxhim i Teknologjisë së Informacionit” jep mundësi për studime të specializuara në fushat e menaxhimit të teknologjisë së informacionit në sektorë të ndryshëm të kompanive private dhe institucioneve publike. Ky master u drejtohet së pari individëve që kanë kryer studimet Bachelor në Informatikë, Menaxhim apo degë të afërta me to, dhe është vazhdim i natyrshëm i formimit të tyre të mëparshëm. Njëkohësisht u drejtohet edhe personave të arsimuar në profile të tjera, por që në momentin e aplikimit janë të punësuar në sektorë që kërkojnë këtë lloj formimi, apo atyre që planifikojnë të punësohen në të ardhmen në sektorë ku aplikohet teknologjia e informacionit.

Kurrikula

- o Sistemet e informacionit në organizata
- o Menaxhimi i projekteve në fushën e IT
- o Menaxhimi i proceseve të softuerit
- o Modelet e e-Biznesit
- o Data Warehousing
- o Menaxhim rrjetash



Kriteret

o Kanë përfunduar dhe janë diplomuar në një program të ciklit të parë, i cili rezulton i licensuar në momentin e regjistrimit të studentit dhe i akredituar në momentin e diplomimit të studentit;

o Janë diplomuar jashtë vendit në një program studimi të ciklit të parë, të licensuar dhe akredituar dhe diploma e tyre është njehësuar nga MASR/QSHA brenda dhjetorit 2018.

Karriera

Mundësi punësimi në sektorin e teknologjisë së informacionit për:

- o Prodhimin e softuereve të ndryshme; dhe për
- o Zbatimin e sistemeve të informacionit për palë të treta, në:
 - Sistemin bankar;
 - Sistemin shëndetësor;
 - Sistemin e transportit;
 - Biznesin elektronik;
 - Sektorin e turizmit;
 - Sektorin e prodhimint;
 - drejtoritë apo sektorët e teknologjisë së informacionit në organet e qeverisjes vendore (bashki, komuna) etj.

Kohëzgjatja & forma e studimit

Studime me kohë të plotë

Kohëzgjatja normale e studimeve në program
✓ **1 vit akademik.**

Kohëzgjatja maksimale e studimeve në program
✓ **2 vite akademikë**

Dokumentacioni mbështetës për aplikim:

1. Fotokopje Kartë Identiteti / pasaportë;
2. Fotokopje e diplomës së ciklit të parë e noterizuar / diplomë tjetër studimi e fituar jashtë shtetit dhe e njehsuar nga MASR;
3. Vërtetim i listës së notave dhe krediteve / suplementi i diplomës;
4. Fotokopje e noterizuar e diplomës së Maturës Shtetërore + Çertifikatë e notave, e konfirmuar nga DAR/ZA.
5. CV;
6. 2 fotografi;
7. Mandatë pagesa për tarifën e aplikimit të kryer në UMB.



Kontakte të departamentit:

☎ +355 69 20 67 247 | +355 69 20 41 222

✉ Email: admissions@umb.edu.al